



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PREDSIEDNIK

**RREGULLORE (P) NR. 04/2016
PËR LLOJET E DEKORATAVE DHE PROCEDURAT PËR
DHËNIEN DHE REVOKIMIN E TYRE**

Prishtinë, 21.12.2016



REPUBLIKA E KOSOVËS – PRESIDENTI
REPUBLIC OF KOSOVO – THE PRESIDENT
REPUBLIKA KOSOVO – PRESEDNIK

Presidenti i Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 84 (pika 28) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 të Ligjit nr. 03/L-094 për Presidentin e Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 47, 25 janar 2009), si dhe neneve 5 dhe 18 të Ligjit nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 02, 20 janar 2012), nxjerr:

RREGULLORE (P) NR. 04/2016
PËR LLOJET E DEKORATAVE DHE PROCEDURAT PËR DHËNIEN DHE
REVOKIMIN E TYRE

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i llojeve të dekoratave si dhe procedurat për dhënien dhe revokimin e tyre.

Neni 2
Fushëveprimi

Dispozitat e përcaktuara në këtë rregullore vlejné për dekoratat që jepen dhe revokohen nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

Neni 3
Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
 - 1.1. **President** - nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës;
 - 1.2. **Dekoratë** - nënkupton urdhrat, medaljet, çmimet, titujt e nderit dhe mirënjohjet që i jep Presidenti.
 - 1.3. **Revokim i dekoratës** - heqja e së drejtës dikuajt për bartjen e dekoratës së dhënë nga Presidenti;

- 1.4. **Person** - nëse konteksti nuk nënkupton ndryshe, përfshin personat fizikë dhe personat juridikë;
 - 1.5. **Departamenti për Çështje Juridike (DÇJ)** - nënkupton Departamentin për Çështje Juridike dhe Marrëdhënie Ndërkombëtare në kuadër të Zyrës së Presidentit;
 - 1.6. **Zyrtari përkatës për dekorata** - nënkupton zyrtarin në kuadër të Departamentit për Çështje Juridike;
 - 1.7. **Komision** - nënkupton Komisionin Vlerësues për Dekorata;
 - 1.8. **Ligj** - nënkupton Ligjin nr. 04/L-070 për dhënien e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 02, 20 janar 2012).
2. Shprehjet e tjera të përdorura në këtë rregullore kanë kuptimin e njëjtë si në përkufizimet e Ligjit.

II. LLOJET E DEKORATAVE

Neni 4

Llojet e dekoratave

1. Presidenti mund të japë këto dekorata:
 - 1.1. Urdhra;
 - 1.2. Medalje;
 - 1.3. Çmime;
 - 1.4. Titujt e nderit dhe
 - 1.5. Mirënjohje.
2. Presidenti mund të japë edhe lloj tjetër të dekoratës, e cila nuk është përcaktuar në këtë rregullore.
3. Për dekoratat e dhëna nga Presidenti, nga pika 1.1 deri në pikën 1.4 të Paragrafit 1 të këtij neni, nxirret vendimi dhe certifikata, e cila shoqërohet me medaljen përkatëse. Të dekoruarit i dorëzohen certifikata dhe medalja përkatëse, sipas ceremonisë që vendos Presidenti.
4. Për mirënjohje nxirret vendimi dhe certifikata. Të dekoruarit me mirënjohje i dorëzohet certifikata, sipas ceremonisë që vendos Presidenti.

Neni 5

Urdhrat

1. Llojet e urdhrave janë si në vijim:
 - 1.1. Urdhri “Hero i Kosovës”;
 - 1.2. Urdhri i Lirisë;
 - 1.3. Urdhri i Pavarësisë;
 - 1.4. Urdhri “Hasan Prishtina”;
 - 1.5. Urdhri “Shote Galica”;
 - 1.6. Urdhri “Luftëtar i Lirisë - Adem Jashari”;
 - 1.7. Urdhri “Dr. Ibrahim Rugova”.

Neni 6 Medaljet

1. Llojet e medaljeve janë si në vijim:
 - 1.1. Medalja Presidenciale “Shën Tereza”;
 - 1.2. Medalja Presidenciale për Sundim të Ligjit;
 - 1.3. Medalja Presidenciale Ushtarake;
 - 1.4. Medalja Presidenciale për Siguri;
 - 1.5. Medalja Presidenciale “Anton Çetta”;
 - 1.6. Medalja Presidenciale e Meritave.

Neni 7 Çmimet

1. Llojet e çmimeve janë si në vijim:
 - 1.1. Çmimi për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim.
 - 1.2. Çmimi “Mjeshtër i Merituar”.

Neni 8 Titujt e nderit

1. Llojet e titujve të nderit janë si në vijim:
 - 1.1. Titulli: Nderi i Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Titulli: Ambasador Nderi i Republikës së Kosovës;
 - 1.3. Titulli: Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës.

Neni 9 Mirënjohjet

Mirënjohje u jepet personave që me punën e tyre kanë kontribuar dhe kontribuojnë në fusha të ndryshme.

III. URDHRAT

Neni 10 Urdhri “Hero i Kosovës”

Urdhri “Hero i Kosovës” u jepet personave që kanë bërë vepra trimërie dhe sakrifice si dhe për veprimtari ose akte të guximit qytetar në kohë lufte apo paqeje.

Neni 11
Urdhri i Lirisë

Urdhri i Lirisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut të lartë për liri të Kosovës.

Neni 12
Urdhri i Pavarësisë

Urdhri i Pavarësisë u jepet personave që kanë dhënë kontribut të lartë për pavarësinë e Kosovës.

Neni 13
Urdhri “Hasan Prishtina”

Urdhri “Hasan Prishtina” u jepet personave që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për veprimtari atdhetare.

Neni 14
Urdhri “Shote Galica”

Urdhri “Shote Galica” u jepet personave për vepra trimërie apo për veprimtari ose akte të guximit për barazi gjinore.

Neni 15
Urdhri “Luftëtar i Lirisë - Adem Jashari”

Urdhri “Luftëtar i Lirisë -Adem Jashari” u jepet personave për trimëri, sakrificë apo flijim në luftën për liri.

Neni 16
Urdhri “Dr. Ibrahim Rugova”

Urdhri “Dr. Ibrahim Rugova” u jepet personave për kontribut në ndërtimin e paqes apo në zhvillimin e demokracisë.

IV. MEDALJET

Neni 17
Medalja Presidenciale “Shën Tereza”

Medalja Presidenciale “Shën Tereza” u jepet personave për kontribut në fushën e humanizmit dhe paqes.

Neni 18
Medalja Presidenciale për Sundim të Ligjit

Medalja Presidenciale për Sundim të Ligjit u jepet personave për kontribut në fushën e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

Neni 19
Medalja Presidenciale Ushtarake

Medalja Presidenciale Ushtarake u jepet personave për kontribut në fushën e mbrojtjes së Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Neni 20
Medalja Presidenciale për Siguri

Medalja Presidenciale për Siguri u jepet personave për kontribut në fushën e sigurisë së Republikës së Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Neni 21
Medalja Presidenciale “Anton Çetta”

Medalja Presidenciale “Anton Çetta” u jepet personave për kontribut për pajtim dhe paqe mes njerëzve apo kontribut për të drejtat e njeriut.

Neni 22
Medalja Presidenciale e Meritave

Medalja Presidenciale e Meritave u jepet personave për kontribut në fusha të veçanta, si në: arsim, shkencë, art, kulturë, rini, sport, shëndetësi e shërbim civil.

V. ÇMIMET

Neni 23
Çmimi për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim

Çmimi për Inovacion, Kërkim dhe Zhvillim u jepet personave për kontribut dhe rezultate inovative, kërkimore dhe zhvillimore në fusha të caktuara.

Neni 24
Çmimi “Mjeshtër i Merituar”

Çmimi “Mjeshtër i Merituar” u jepet personave për kontribut në fusha të ndryshme: të shkencës, arsimit, artit, sportit, kulturës, punës, prodhimit dhe biznesit, për punë të shquar profesionale dhe kontribut të jashtëzakonshëm jetësor në zhvillimin e sektorit përkatës.

VI. TITUJT E NDERIT

Neni 25

Titulli: Nderi i Republikës së Kosovës

Titulli: Nderi i Republikës së Kosovës u jepet personave që me veprat dhe emrin e tyre nderojnë Republikën e Kosovës.

Neni 26

Titulli: Ambasador Nderi i Republikës së Kosovës

Titulli: Ambasador Nderi i Republikës së Kosovës u jepet personave që kanë kontribuar dhe kontribuojnë për interesat dhe afirmimin e Republikës së Kosovës.

Neni 27

Titulli: Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës

Titulli: Qytetar i Merituar i Republikës së Kosovës u jepet personave që me veprimtarinë e tyre, brenda dhe jashtë vendit, kanë kontribuar dhe kontribuojnë në mbrojtjen dhe promovimin e interesave të Republikës së Kosovës dhe bëjnë vepra të mira për vendin.

VII. PROCEDURAT PËR DHËNIEN E DEKORATAVE

Neni 28

Dhënia e dekoratës

1. Dhënia e dekoratës bëhet duke marrë parasysh kontributin dhe meritat e personave.
2. Të propozuarit për dekoratë duhet të shquhen për kontribut dhe merita të veçanta në shërbim të shoqërisë, Republikës së Kosovës dhe interesave të saj.
3. E njëjta dekoratë nuk mund t'i jepet dy herë të njëjtit person.

Neni 29

Dhënia e dekoratës me vetiniciativë

1. Presidenti mund të japë dekoratë me vetiniciativë.
2. Në rastin kur Presidenti vendos t'i japë dekoratë një personi, Departamenti për Çështje Juridike përgatit vendimin, certifikatën dhe siguron medaljen përkatëse.

Neni 30

Shqyrtimi i propozimit për dekoratë

1. Subjektet që kanë të drejtën e propozimit për dekoratë te Presidenti, sipas ligjit, duhet t'i plotësojnë kriteret e mëposhtme:
 - 1.1. Dërgohet 2 (dy) muaj para veprimtarisë, përvjetorit apo ngjarjeve historike që i përket personit apo institucionit;
 - 1.2. Nënshkruhet nga propozuesi që ka të drejtën e propozimit, ku përfshihen kontaktet e propozuesit (emri dhe mbiemri, pozita apo profesioni, adresa, nr. tel, e-maili);
 - 1.3. Shoqërohet me arsyetimin përkatës, ku paraqiten arritjet dhe meritat e veçanta të të propozuarit me biografi të personit të propozuar;
 - 1.4. Mendimi i Ministrisë përkatëse për Punë të Brendshme dhe mendimi i Ministrisë përkatëse për Forcën e Sigurisë së Kosovës, në rastet kur kërkohet një gjë e tillë sipas ligjit.
2. Propozuesit janë përgjegjës për të gjitha të dhënat dhe dëshmitë e paraqitura me rastin e propozimit.
3. Të gjitha propozimet që i drejtohen Presidentit, nga subjektet që janë të përcaktuara në ligj, i barten Departamentit për Çështje Juridike për procedurë të mëtejshme, nëse Presidenti nuk vendos ndryshe.
4. Presidenti, nëse e vlerëson të nevojshme, një propozim të dhënë nga subjektet që janë të përcaktuara në ligj mund të vendosë që të mos e dërgojë në procedurë të mëtejshme në Komision dhe ta dekorojë atë person. Këto raste konsiderohen si dhënie e dekoratës me vetiniciativë.
5. Departamenti për Çështje Juridike verifikon nëse propozimi i përmbush kriteret përkatëse.
6. Nëse propozimi nuk është i plotë, Departamenti për Çështje Juridike kërkon nga propozuesi të bëjë plotësimin.
7. Nëse propozimi bëhet nga subjektet që nuk kanë të drejtën e propozimit për dekoratë, Departamenti për Çështje Juridike e udhëzon propozuesin për procedurat ligjore dhe e njofton Kabinetin e Presidentit.
8. Nëse Presidenti e vlerëson të nevojshme, një propozim të dhënë nga subjektet që nuk kanë të drejtën e propozimit për dekoratë, mund të vendosë të japë dekoratë me vetiniciativë.
9. Nëse propozimi për dekoratë është i plotë, Departamentit për Çështje Juridike bën paraqitjen e tij te Komisioni.
10. Komisioni, sipas rregullave dhe procedurave përkatëse, shqyrton dhe vlerëson propozimin për dekoratë dhe përgatit rekomandimin për Presidentin.
11. Presidenti vlerëson rekomandimin e Komisionit, e miraton ose nuk e miraton, vendos për të dhënë dekoratë tjetër nga ajo që është propozuar ose e riformulon motivacionin.
12. Në rast kur rekomandimi miratohet nga Presidenti, Departamenti për Çështje Juridike përgatit vendimin, certifikatën dhe siguron medaljen përkatëse.

VIII. PROCEDURA PËR REVOKIMIN E DEKORATAVE

Neni 31

Revokimi i dekoratës

1. Revokimi i dekoratës bëhet siç është përcaktuar në Nenin 14 të ligjit:
 - 1.1. Të dekoruarit mund t'i revokohet dekorata nëse vepron në kundërshtim me rendin publik, moralin dhe kryen vepra të tjera që e bëjnë të padenjë për bartjen e dekoratës;
 - 1.2. Presidenti me vendim revokon dekoratën për personin sipas Paragrafit 1.1 të këtij neni;
 - 1.3. Propozimin për revokimin e dekoratës mund ta bëjë propozuesi për dekoratë apo Komisioni;
 - 1.4. Presidenti mund ta revokojë dekoratën me vetiniciativë.

IX. EVIDENCA, PUBLIKIMI I VENDIMEVE PËR DEKORATAT E DHËNA DHE TË REVOKUARA NGA PRESIDENTI DHE BARTJA E DEKORATËS

Neni 32

Evidenca për dekoratat e dhëna dhe të revokuara nga Presidenti

1. Dekoratat që jepen nga Presidenti evidentohen në një regjistër të veçantë, i cili administrohet dhe përditësohet nga Departamenti për Çështje Juridike, gjegjësisht zyrtari përkatës për dekorata.
2. Zyrtari përkatës për dekorata mban evidencën për emrin dhe mbiemrin e personit të dekoruar, llojin e dekoratës, propozuesin, arsyetimin dhe shënime të tjera për dhënien e dekoratës.
3. Zyrtari përkatës për dekorata mban evidencë edhe në rast të revokimit të dekoratës.

Neni 33

Evidenca për dekoratat e dhëna nga shtetet e tjera për shtetasit e Republikës së Kosovës

1. Zyrtari përkatës për dekorata mban evidencën edhe për shtetasit e Republikës së Kosovës që kanë marrë dekorata nga shtetet e tjera ose organizata ndërkombëtare.
2. Shtetasi i Republikës së Kosovës duhet ta njoftojë zyrtarin përkatës për dekorata nëse merr dekoratë nga ndonjë shtet tjetër ose organizatë ndërkombëtare.

Neni 34

Publikimi për dhënien apo revokimin e dekoratës

Vendimi për dhënien apo revokimin e dekoratës nga Presidenti publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në ueb-faqen zyrtare të Presidentit të Republikës së Kosovës.

Neni 35
Bartja e dekoratës

Dekoratën e bart vetëm i dekoruari, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në ligj.

X. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 36
Përzgjedhja e modeleve të dekoratave

1. Përzgjedhja e modeleve të dekoratave, të përcaktuara në këtë rregullore, bëhet nëpërmes konkursit publik.
2. Sekretari i Zyrës së Presidentit, në afat prej 3 muajsh nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje, bën shpalljen publike për përzgjedhjen e modeleve të dekoratave.
3. Sekretari emëron Komisionin për shqyrtimin e propozimeve të pranuar nga shpallja publike.
4. Komisioni, pas shqyrtimit të propozimeve për modele të dekoratave, i rekomandon Presidentit deri në tri modele për secilën dekoratë.
5. Presidenti vendos për modelin e dekoratës përkatëse.
6. Sipas modeleve të përzgjedhura të dekoratave përkatëse nga Presidenti, bëhet punimi i tyre sipas legjislacionit në fuqi.
7. Pas punimit të modeleve të dekoratave, fotot e secilës dekoratë bëhen pjesë e kësaj rregulloreje dhe Departamenti për Çështje Juridike i publikon si shtojca të kësaj rregulloreje.

Neni 37
Dekoratat e mëparshme

Dekoratat e dhëna më parë e ruajnë vlefshmërinë dhe të dekoruarit kanë të drejtë t'i bartin dekoratat e tyre, por revokimi i dekoratave bëhet sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 38
Shfuqizimi

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen:
 - 1.1. Rregullorja me nr. protokollit 101, e datës 29.01.2013 mbi Llojet e Dekoratave që i jep Presidenti i Republikës së Kosovës dhe procedurat për dhënien e tyre.
 - 1.2. Rregullorja (P) nr. 01/2016 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores mbi Llojet e Dekoratave që i jep presidenti i Republikës së Kosovës dhe procedurat për dhënien e tyre (28 korrik 2016).
2. Deri në përfundimin e punimit të dekoratave të përcaktuara me këtë rregullore vazhdojnë të zbatohen llojet e dekoratave të përcaktuara në rregulloret e cekura në Paragrafin 1 të këtij neni.

Neni 39
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi nga ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI,
President i Republikës së Kosovës

Prishtinë, 21.12.2016